



01/Nr.10134/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 14, 40, Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005 neni 9, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 neni 2 dhe 9, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 merr:

### VENDIM

#### PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike.
2. Normat tatimore vendosen brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë dhe janë të vlefshme nga fillimi i vitit tatimor 2020:

Nr.	Kategoria e pronës	Norma tatimore
1	Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
2	Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
3	Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%
4	Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
5	Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
6	Për njësitë komerciale të parcelave	0.15%
7	Për njësitë komerciale të objekteve	0.20%
8	Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
9	Për njësitë industriale të objekteve	0.20%

3. Konfirmohet baza e tatimit në pronë dhe zonat tatimore për njësitë komerciale dhe industriale të objekteve të aplikueshme gjatë vitit 2019 të njëjtat të jenë edhe për vitin 2020.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa- Sektori i tatimit në pronë.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministrisë së Financave-Departamentit të tatimit në pronë,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa-Sektorit të tatimit në pronë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 27.11.2019





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10110 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 merr:

**V E N D I M**  
**PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Avdi Dernjani sipas kërkesës së tij.
2. Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 300 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Grana Pole" zona kadastrale Paldenicë, më kulturë arë e klasit të gjashtë (6), e evidentuar në emër të z. Avdi Dernjani, sipas certifikatës pronësore P-73317066-00748-1.
3. Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtim për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Pala,
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër,
- Drejtoria për Bujqësi,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 27.11.2019





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10133 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, Rregulloren 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, në harmoni me Strategjinë Shtetërore për Ri integrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë, të aprovuar në mars të vitit 2018 nga Qeveria e Republikës së Kosovës neni 75, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR RI – INTEGRIM TË QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR 2019 - 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Planin Komunal të Veprimit për Ri – integrimin e Qëndrueshëm të Personave të riatdhesuar në komunën e Hanit të Elezit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Komunal i Veprimit për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për vitin 2019 - 2022 i cili përbëhet nga 46 faqe.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Zyra për Komunitete dhe Kthim
- Drejtoria për Administratë
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 27. 11. 2019

Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10104 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 merr:

**V E N D I M**  
**PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Illir Bushi sipas kërkesës së tij.
2. Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 200 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Rana" zona kadastrale Pustenik, më kulturë arë e klasit të pestë (5), e evidentuar në emër të z. Ilir Bushi, sipas certifikatës pronësore P-73317070-01395-0.
3. Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtim për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Pala,
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër,
- Drejtoria për Bujqësi,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 27.11.2019





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10135 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 Nr. 06/L-133 neni 3, paragrafi 1.40, neni 12, neni 15 paragrafi 6, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 merr:

VENDIM  
PËR TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE  
PAGA DHE MËDITJE PËR VITIN 2019

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2019.
2. Transferi i mjeteve në total është në shumë prej 11,071.00 € nga fondi 10 në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje sipas tabelës 4.1 të bashkangjitur këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 27. 11. 2019



**Tabela 4.1. Transferet në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje**

Programet Buxhetore	Kodi i Org.	Kodi i progr.	Kodi i nën-progr.	Kodi funksional	Zbritja e mjeteve	Rritja e mjeteve
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	659	195	19675	1090	-1,071.00	
Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural	659	470	47115	0422	-4,500.00	
Planifikimi urban dhe mjedisi	659	660	66480	0620	-5,500.00	
Zyra e kryetarit	659	160	16035	0111		2,601.00
Administrata dhe personeli	659	163	16335	0133		1,497.00
Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjenca	659	180	18444	0320		1,060.00
Zhvillimi ekonomik	659	480	48035	0411		156.00
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	659	755	75671	1040		361.00
Arsimi dhe shkenca	659	920	92175	0980		538.00
Arsimi dhe shkenca	659	920	94020	0912		4,858.00
<b>Totali</b>					<b>-11,071.00</b>	<b>11,071.00</b>

Hani i Elezit  
Data: 27. 11. 2019





01/Nr. 10787/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 51.1, 52, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 4, Statuti i Komunës neni 37, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 merr:

**V E N D I M**  
**PËR PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
2. Komitetit për Politikë dhe Financa përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:
  1. Qamush Brava - Kryesues i Kuvendit të Komunës
  2. Sabedin Hasallari - LDK
  3. Mehemet Ballazhi - PDK
  4. Nora Xhoni - AAK
  5. Teuta Shkreta - VV
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:27.11.2019

